



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e I-re të rregullt të punës për vitin 2019.

Seanca mbahet më 31.01.2019 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Për këtë seancë propozohet ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Raporti ekonomik-financiar për zbatimin e planeve investuese të Komunës për gjashtëmuorin e II-të të vitit 2018 (raporton Kryetari i Komunës),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar i Komunës për vitin 2018 (ref.Drejtori i FEZH),
7. Shqyrtimi i rekomandimeve të KPF për procesverbalin e Takimit me Qytetar të datës 18.12.2018,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2019 (ref. Zyrtari për Informim),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për mos dhenje të pëlqimit nga Komuna, për ushtrimin e veprimtarisë afariste-gurore me minim (gurthyvesve) (ref.Drejtorja e Bujqësisë dh Zhvillimit Rural),
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit për shpalljen e Sportistit të Vitit 2018, AD HOC (ref. Drejtorja e KRS),
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete nga komuniteti serb (Suzana Smigiq me Tanja Kostiq),
12. Interpelanca për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nga IPK-Gjokë Lleshaj.

01Nr. 06-3126 2019
Klinë, më 22.01 2019



KRYESUESI
Anëtari me i vjetër i KK
Zeqir Morina